

Nxitja e diversitetit dhe barazisë në Ballkanin Perëndimor

Cili është qëllimi?

- ▶ Adresimi i fenomeneve të gjuhës së urrejtjes dhe mbështetja e vendeve përfituese në Ballkanin Perëndimor në kundërvënien ndaj gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes;
- ▶ Nxitja dhe mbrojtja e të drejtave të personave LGBTI dhe grupeve të tjera të prekshme sociale në rajon.
- ▶ Forcimi i kapaciteteve dhe bashkërendimit institucional, si dhe përmirësimi i mekanizmave anti-diskriminues në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- ▶ Mbështetja e autoriteteve publike në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi në zbatimin e rekomandimeve të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kush përfiton nga ky projekt?

- ▶ Organet e Barazisë/Institucionet e të Drejtave të Njeriut në vendet përfituese;
- ▶ Autoritetet e zbatimit të ligjit;
- ▶ Komunitetet LGBTI dhe grupe të tjera të prekshme sociale;
- ▶ Organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ▶ Publiku në përgjithësi.

Si do të funksionojë projekti?

- ▶ Ky projekt mbështet studimet dhe mbledhjen e mëtejshme të të dhënave nga Organizmat e Barazisë dhe organizatat në terren, duke u fokusuar tek situata e gjuhës së urrejtjes dhe te shkëmbimi i përvojave të tyre dhe praktikave të mira lidhur me luftën kundër gjuhës së urrejtjes;
- ▶ Projekti ndihmon Organet e Barazisë dhe autoritetet e zbatimit të ligjit në përpjekjet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes në nivel lokal dhe rajonal;
- ▶ Projekti mbështet procesin e ndërtimit të kapaciteteve të Organizmave të Barazisë dhe të autoriteteve të në ndihmë të viktimave me qëllim uljen e mosraportimit sa duhet të rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes.

Çfarë presim të arrijë ky projekt?

- ▶ Ndërgjegjësimin më të madh të popujve dhe komuniteteve në rajonin e Ballkanit Perëndimor për rrezikun e pashmangshëm të gjuhës së urrejtjes dhe ndikimeve negative të saj në shoqërinë tonë;
- ▶ Garantimin e Organizmave të pavarur dhe efikasë të Barazisë që janë lehtësisht të aksesueshëm për viktimat apo komunitetet e rrezikuara nga diskriminimi dhe intoleranca;
- ▶ Krijimin dhe zhvillimin e njohurive dhe praktikave të përbashkëta në fushën e luftës kundër krimeve të urrejtjes dhe luftës kundër diskriminimit bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe tek përvoja më e mirë;
- ▶ Forcimin e reagimit ndërkuftar ndaj krimit të urrejtjes dhe diskriminimit, duke kontribuar në bashkëpunimin e përgjithshëm mes autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të kësaj fushe për përforcimin e dialogut dhe besimit nga komunitetet dhe organizatat LGBTI.

Sa do të kushtojë ky projekt?

- ▶ Buxheti total i këtij projektit është 400,000 Euro;
- ▶ Buxheti i caktuar për programin e Instrumentit Horizontal në përgjithësi shkon rreth 41 milionë Euro (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës).

Si të marrim më shumë informacion?

- ▶ Këshilli i Evropës, faqja e internetit e Departamentit të Anti-Diskriminimit: <https://www.coe.int/en/web/inclusion-and-antidiscrimination>
- ▶ Faqja e internetit e Instrumentit Horizontal: <https://jip-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Marija Simić, Këshilltare për Komunikimin e Instrumentit Horizontal, Marija.SIMIC@coe.int, +381 63 601 337
Besnik Baka, Këshilltar për Komunikimin e Instrumentit Horizontal, Besnik.Baka@coe.int, +355 69 217 8430

Rreth Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një nismë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u jep mundësi vendeve përfituese të përmbushin axhendat e tyre të reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë dhe në arritjen e standardeve evropiane, në kuadrin e procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar mbulon projektet në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Turqi, si dhe në Kosovë* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës që prej muajit maj 2019.

**Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës*

Këshilli i Evropës është organizata lider e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke ruajtur në të njëjtën kohë diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vende dhe popuj përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Kjo fletëpalosje është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të asnjërës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës